

VENDIM
Nr. 174, datë 26.3.2014

**PËR RIALOKIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE TË FONDEVE BUXHETORE NË NJËSITË
E QEVERISJES QENDRORE PËR VITIN 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 11 e 17 të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit bëhet 23 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të institucioneve të tjera qeveritare në 269 veta.
 2. Numri i punonjësve përballohet nga rezerva e parashikuar në ligjin vjetor të buxhetit, numri total i së cilës bëhet 9 veta.
 3. Në programin “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme, pakësohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”.
 4. Në programin “Shërbime të tjera”, në buxhetin e miratuar të vitit 2014, për Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë lekësh), në zërin “Shpenzime korrente”.
 5. Ngarkohen institucionet e përmendura më sipër dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama